

Mbi kërkesën për procedim disiplinor me masën “Shkarkim nga detyra”, për magjistraten A.Ll.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor ndaj magjistrates A.Ll., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, bazuar në 11 ankesa për mospërbushje të rregullt të detyrës, e shkelje të afateve procedurale civile e penale. Gjithashtu gjatë hetimit disiplinor, nga inspektorët janë evidentuar edhe fakte të tjera, të cilat i janë shtuar hetimit të nisur.

Hetimi i inspektorëve të ILD-së ka konkluduar se:

- Nga ana e magjistrates subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të afateve procedurale civile dhe penale të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe mosvënien në lëvizje të çështjeve civile, duke tejkaluar afatet tej çdo llogjike, e në mënyrë të vazhdueshme, çka është thuajse e barabartë me mungesën e drejtësisë.

Ndër konstatimet e raportit:

- Në shumë raste nga regjistrimi i çështjeve dhe caktimi i tyre gjyqtare, janë evidentuar mos kryerje veprimesh për një periudhë prej rreth mbi 3 vite.
- Rreth 64% e çështjeve civile të themelit për vitin 2021 dhe 90% për vitet 2022 dhe 2023 janë në tejkalim të afatit ligjor të arsyetimit/dorëzimit (vendime të llojit kryesisht vërtetim fakti juridik për njohje vërtetësie e zgjidhje martese, njohje pronësie apo pjestim pasurie.)
- Vonesa të ngjashme janë evidentuar në urdhëra ekzekutimi (78% e çështjeve në 2023); lëshim i urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes/vërtetim urdhëri (deri në 60% e vendimeve tej afatit ligjor të arsyetimit/dorëzimit për vitin 2023); për kërkesa penale kryesisht ankim ndaj vendimit të mos fillimit të prokurorit (85% e vendimeve në vitin 2023, të padorëzuara); për kërkesa penale “masa sigurimi” ku përfshihen edhe vendime lejim/vleftësim përgjimi/kontrolli, tej afatit ligjor të arsyetimit/dorëzimit janë 6% e vendimeve për vitin 2021, 16% për vitin 2022 dhe 66% për vitin 2023. Vendimet e padorëzuara në vitin 2023 janë 43% e vendimeve tej afatit ligjor.
- Veprimet e magjistares janë kryer të paktën me pakujdesi në formë neglizhencës, e përsëritur dhe e vazhdueshme, e në disa raste kanë shkaktuar dëm në procedurat hetimore.
- Gjyqtarja ka dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, edhe pse ka 24 vite eksperiencë, tregues i njohjes shumë të mirë të ushtrimit të detyrës me disiplinë.
- Vonesat në mosvënien në lëvizje të gjykimit dhe të arsyetimit të vendimeve gjyqësore nuk justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me magjistratin.

Nga hetimi bazuar në materialet voluminoze të administruara e shqyrtuara, arrihet në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga gjyqtarja përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”, parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” dhe “dh” të ligjit “Për statusin”. ILD i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistaren A. Ll., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.